

1 E hënë, 1 shkurt 2021

2 [Konferencë për Ecurinë e Çështjes]

3 [Seancë e hapur]

4 [I akuzuari nuk është i pranishëm]

5 --- Fillon në orën 11.00

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëmëngjes të gjithëve në
7 sallën e gjyqit dhe jashtë saj.

8 Z. Sekretare, ju lutem paraqisni çështjen.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kjo është çështja KSC-
10 BC-2020-05, Prokurori kundër z. Salih Mustafa.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Sekretare.

12 Tani u kërkoj palëve, ju lutem prezantohuni, duke filluar
13 nga Zyra e Prokurorit të Specializuar.

14 Z. Prokuror.

15 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit i nderuar
16 Gjykatës. Mirëmëngjes të gjithëve. Prokuroria përfaqësohet sot
17 nga Alex Whiting, zëvendësprokuror i specializuar; unë, Cezary
18 Michalczuk, prokuror; Silvia D'Ascoli, prokurore; Filippo de
19 Minicis, ndihmësprokuror; dhe Aniko Boldog, që është asistente
20 për menaxhimin e provave.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

22 Tani Mbrojtja.

23 Z. VON BONE: [Përkthim] Unë jam Julius von Bone. Jam
24 mbrojtës i z. Salih Mustafa. Z. Mustafa nuk do të jetë i
25 pranishëm sot. Ai këtë e ka konfirmuar me një deklaratë me

1 shkrim. Pra, jam i vetmi për këtë palë sot.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Unë, për procesverbalin,
3 jam Nicolas Guillou, Gjykatësi i Procedurës Paraprake.

4 Më 26 janar unë caktova një datë për Konferencën e
5 Statusit të katërt në këtë çështje. Qëllimi im sot është që të
6 shikojmë se ku është gjendja me përgatitjen e çështjes.

7 Unë e shikoj që palët nuk kanë dhënë asnjë parashtrim me
8 shkrim. Dhe do t'u kërkoj palëve që të japin parashtrimet e
9 tyre me gojë, së pari për urdhrin për caktimin e datës, pastaj
10 për nxjerrjen e materialeve për hetimet, dhe pastaj për pikat
11 për të cilat është rënë dakord, pikat juridike dhe faktike,
12 dhe për hapat e mëtejshëm proceduralë.

13 Unë i kujtoj palët, si gjithmonë, që në qoftë se kanë
14 ndonjë material apo parashtrim që kërkon nxjerrjen e
15 informacionit konfidencial të na njoftojnë paraprakisht.

16 Përpara se të kalojmë me pikën e parë të rendit të ditës,
17 dua të lëshoj një urdhër për parashtrim nga të dy palët. I
18 kujtoj palëve që në Konferencën e tretë të Statusit më 14
19 dhjetor 2020, një pjesë e seancës u krye në seancë të mbyllur
20 me kërkesën e Mbrojtjes.

21 Për të qenë sa më transparent me publikun, u kërkoj
22 palëve që të bëjnë parashtrime të përbashkëta me shkrim deri
23 të hënën 15 shkurt 2021, për një version me më pak redaktime
24 të transkriptimit të Konferencës së tretë për Ecurinë e
25 Çështjes, dhe i falënderoj palët paraprakisht për këto

1 parashtime.

2 Tani të kaloj në pikën e parë të rendit të ditës, që
3 është, nëse Prokuroria ka përfunduar nxjerrjen e materialeve
4 përfshirë edhe materialet apo provat shfajësuese; dhe në qoftë
5 se jo, çfarë materialesh kanë mbetur pa nxjerrë, sipas cilit
6 rregull, dhe kur do t'i nxjerrë Prokuroria këto materiale. Po
7 kështu ftoj prokurorin të thotë nëse Prokuroria dëshiron të
8 shtojë prova sipas rregullës 102(2) të Rregullores.

9 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Me lejen tuaj, para sesa të
10 kaloj te pikat e nxjerrjes së materialeve desha -- dua të bëj
11 disa vërejtje paraprake nga Prokuroria.

12 Unë desha të them, desha të theksoj pozicionin e
13 përgjithshëm të Prokurorinë në lidhje me procesin paraprak.
14 Duke qenë se tani në përgjithësi procesi i nxjerrjes së
15 materialeve ka mbaruar, dhe ne mendojmë si Prokurori që të
16 përfundohet faza paraprake në shkurt dhe të vazhdohet me
17 dorëzimin e dosjes paraprake sipas rregullës 95(4).

18 Ne themi që do ta dorëzojmë këtë dosje më 15 shkurt dhe
19 mendojmë që duhet të përpigemi ta fillojmë çështjen që në 15
20 mars 2021 -- që në mars të 2021-it.

21 Për sa i përket nxjerrjes së materialeve do t'ia jap
22 fjalën Silvia D'Ascoli-t.

23 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit. Faleminderit. Të
24 gjithëve këtu në sallën e gjyqit mirëmëngjesi.

25 Pra, dua të trajtoj çështjen e parë në lidhje me

1 nxjerrjen e materialeve, dhe do të them në hollësi se çfarë
2 është thënë dhe çfarë ka mbetur për t'u bërë.

3 Që në fillim Prokuroria thotë që nxjerrja e materialeve
4 nga Prokuroria tashmë pothuaj ka përfunduar dhe do të
5 përfundojë afërsisht në dy javë, pra, më 15 shkurt.

6 Tani do të jap disa hollësi specifike në lidhje me
7 procesin e nxjerrjes së materialeve sipas rregullave. E para
8 102(1)(b), pastaj do të kaloj te nxjerrja e materialeve sipas
9 rregullës 102(2), dhe në fund, për provat shfajësuese.

10 Siç u raportua edhe në Konferencën e mëparshme për
11 Ecurinë e Çështjes, Prokuroria e ka përfunduar në përgjithësi
12 nxjerrjen e materialeve sipas rregullës 102(1)(a) dhe (b) në
13 tetor -- nga tetori deri në dhjetor të vitit 2020, në
14 përputhje me afatet që kishte caktuar Gjykatësi.

15 Përveç kësaj, më 29 janar 2021, Prokuroria nxori një
16 provë tjetër, në bazë të rregullës 102(1)(b), që është
17 nxjerrja e materialeve numër 30. Kjo ishte rezultati i
18 vlerësimit që u bë për provat që ishin mbledhur nga zoti -- që
19 ishin marrë nga z. Mustafa.

20 Pas kësaj, Prokuroria do të shtojë edhe një dëshmitar në
21 listën e saj. Ky është një dëshmitar që është intervistuar nga
22 Prokuroria dhe ne po vlerësojmë tani provat e tij. Në qoftë se
23 ky dëshmitar do të shtohet në listë, atëherë ky -- të gjitha
24 materialet në lidhje me të do t'i nxirren Mbrojtjes deri më 15
25 shkurt.

1 Do të ketë ndoshta edhe një material tjetër që do të
2 nxirret në bazë të rregullës 102(1)(b). Kjo do të jetë një
3 nxjerrje që ka të bëjë vetëm me disa prova dhe është rezultat
4 i shqyrtimit të materialit provues që po bëjmë ne në kuadër të
5 përgatitjes së dosjes paraprake. Në fund të këtij procesi ka
6 disa prova që mund të nxirren sipas rregullës 102(1)(b). Kemi
7 identifikuar deri tani dy, por mund të ketë edhe të tjera.

8 Dhe duke -- sa për t'ju dhënë një ide për këto -- për
9 natyrën e këtyre provave, ka -- këto dokumente që mund të
10 quhen "kuazi" [fonetakisht] dokumente, p.sh., kopje të provave
11 që tashmë i ka nxjerrë Prokuroria, disa montazhe fotografish
12 apo deklaratash të mëparshme që i kemi gjetur edhe në një grup
13 tjetër materialesh. Dhe të gjitha këto do të përfundojnë deri
14 më 15 shkurt, dhe çdo nxjerrje tjetër materialesh që do të
15 bëhet, nëse do të ketë, do të përfundojë deri më 15 shkurt,
16 dhe pastaj mund të kalojmë te dorëzimi i dosjes paragjyqësore,
17 paraprake.

18 Tani, për sa i përket rregullës 102(2), edhe procesi për
19 dorëzimin e materialeve në lidhje me të ka përfunduar. Lista i
20 është dhënë Mbrojtjes më 1 dhjetor 2020. Mund të ketë ndonjë
21 shtesë në këtë listë, rreth 12 prova, të cilat ne do t'i
22 shtojmë te lista e materialeve në bazë të rregullës 102(2).
23 Këto materiale janë p.sh., intervista që janë bërë kohët e
24 fundit nga Prokuroria, apo janë përpunuar kohën e fundit nga
25 Prokuroria në sistemin tonë.

1 Dhe kjo do të bëhet përmes parashtimeve të cilat do të
2 protokollohen dhe do të plotësojnë listën e 1 dhjetorit 2020.
3 Këto do të -- të gjitha përsëri do të dorëzohen më 15 shkurt
4 2021. Disa nga këto prova, sipas rregullës 102(2), do t'i
5 nxirren Mbrojtjes si prova shfajësuese në bazë të rregullës
6 103.

7 Dhe kjo më sjell te pika e fundit, në lidhje me provat
8 shfajësuese dhe nxjerrjen e tyre. Nxjerrja e provave
9 shfajësuese është një proces në vijimësi dhe Prokuroria i ka
10 përmbushur detyrimet e saj në lidhje me këtë që nga fillimi.
11 Ne e kemi nxjerrë pjesën më të madhe të provave shfajësuese
12 gjatë muajit të kaluar dhe do të vazhdojmë të nxjerrim prova
13 të tjera shfajësuese edhe me dosjen paraprake. Ne gjithashtu
14 do të punojmë me zellin e duhur për të bërë shqyrtimin e
15 provave shfajësuese në mënyrë që para sesa të fillojë gjykimi
16 të gjitha këto të kenë përfunduar.

17 Provat e fundit që kemi dorëzuar, provat e fundit
18 shfajësuese që kemi dorëzuar janë bërë më 18 dhjetor 2020 dhe
19 janë futur në sistemin Legal Workflow.

20 Siç kemi thënë edhe në dhjetor gjatë Konferencës së
21 fundit për Ecurinë e Çështjes, Prokuroria duhet t'i drejtohet
22 Gjykatësit të Procedurës Paraprake në lidhje me disa materiale
23 që potencialisht janë shfajësuese për të marrë masa mbrojtëse
24 në formën e redaktimeve paraprake për të mbrojtur identitetin
25 e disa dëshmitarëve. Ne presim që ta dorëzojmë këtë së bashku

1 me dosjen paraprake që do të jetë ndoshta edhe pak më herët
2 sesa 15 shkurti 2020 [siç u përkthye]. Po kështu ne presim që
3 në shkurt 2021, ne do të dorëzojmë dosjen paraprake së bashku
4 materialet që kanë mbetur sipas rregullës 103 të cilat nuk
5 kanë nevojë për redaktime. Të gjitha këto do t'ju dorëzohen
6 juve i nderuar Gjykatës.

7 Pra, në përgjithësi për ta përmbledhur, i nderuar
8 Gjykatës, Dhoma Gjyqësore duhet të jetë e sigurt -- sigurojmë
9 Dhomën Gjyqësore që në shkurt të 2021-it, Prokuroria do t'i
10 ketë nxjerrë pjesën më të madhe të materialeve.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokurore.

12 Pra, nga parashtrimi juaj kuptoj që ju do ta përfundoni
13 nxjerrjen e materialeve deri më 15 shkurt më së voni, dhe
14 pastaj çfarë aplikimesh mund të keni do t'i keni bërë deri
15 atëherë apo jo? Dhe dosja paraprake do të dorëzohet më 15-të.
16 A është e saktë?

17 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po, e saktë.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Von Bone, a keni pasur
19 ndonjë problem apo vështirësi me procesin e nxjerrjes së
20 materialeve?

21 Z. VON BONE: [Përkthim] E vetmja vështirësi që kemi është
22 që disa nga materialet e nxjerra janë vetëm në gjuhën angleze,
23 sidomos disa nga deklaratat. Ato nuk janë përkthyer në shqip
24 dhe kjo na e ndërlikon pak çështjen. Pra, kjo është e vetmja
25 vështirësi që ka sidomos klienti im në lidhje me nxjerrjen e

1 materialeve.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Von Bone.

3 Z. Prokurore, a keni ndonjë gjë për të shtuar në lidhje
4 me këtë? A ka ndonjë përkthim që ka mbetur pa bërë, apo kanë
5 të bëjnë këto me materiale që nuk janë të detyrueshme për t'u
6 përkthyer sipas vendimit tim të mëparshëm?

7 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, të gjitha
8 materialet sipas rregullës 101(a) dhe (b) janë nxjerrë në të
9 dyja gjuhët, shqip dhe anglisht. Nuk e di nëse Mbrojtja e ka
10 fjalën për materialet shfajësuese apo materiale të tjera, por
11 unë mund t'i them mbrojtësit që të na thotë se cilat janë
12 numrat ERN të këtyre materialeve në mënyrë që ne ta ndihmojmë
13 me përgjigje të -- duke i dhënë përgjigje kërkesave të tij.

14 Por unë e konfirmoj që të gjitha materialet sipas
15 rregullës 101(2)(a) dhe (b) janë dorëzuar në të dyja gjuhët.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj.
17 Prokurore.

18 Z. Von Bone, a mund të na thoni se për çfarë deklaratash
19 e keni fjalën d.m.th., dhe në cilën kategori të nxjerrjes së
20 materialeve përfshihen ato?

21 Z. VON BONE: [Përkthim] Kam një që më kujtohet
22 drejtpërsëdrejti. Nuk e di a duhet ta them në seancë të hapur
23 apo të mbyllur?

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Sekretare, a mund të
25 hymë në seancë të mbyllur për pak minuta?

1 [Seancë Private]

2 [Seancë private teksti i fshirë]

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14 [Seancë e hapur]

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi përsëri në seancë
16 të hapur.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit sekretare.

18 Tani kaloj -- i drejtohem përsëri Prokurorisë për pikën e
19 dytë, që është ku është me hetimet e saj në vazhdim.

20 Ju iu përgjigjët disa nga pyetjeve të mia në paraqitjen
21 që bëmë lidhur me nxjerrjen e materialeve, provave, megjithatë
22 a mund të më konfirmoni se dosja juaj paraprake do të jetë e
23 përfunduar në 15 shkurt? Ju thatë gjithashtu se do të më
24 drejtoheni nga mesi i shkurtit, e thatë në konferencën e
25 mëparshme. A mund ta konfirmoni këtë, nëse do të më dërgoni

1 onjë kërkesë në 15 shkurt për këtë çështje?

2 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po. Në të gjitha pikat keni të
3 drejtë.

4 Sa për gjendjen e hetimeve, ne e përmendëm këtë, e
5 diskutuam gjatë konferencës së fundit kur thashë që zyra jonë
6 po kryen hetime edhe për çështje të tjera përveç kësaj. Që do
7 të thotë thjesht se mund të jemi në një situatë ku të gjejmë
8 informacione, prova, të cilat kanë rëndësi edhe për këtë
9 çështje konkrete që po flasim. Dhe kështu mund të jetë e
10 nevojshme që të shtojmë disa pika në këtë hetim. Në këtë rast,
11 sigurisht do t'i përmbahemi detyrimit tonë të nxjerrjes së
12 materialeve, por siç thashë edhe më përpara dhe po e përsëris,
13 ne përveç këtij detyrimi që do t'i përmbahemi, këto gjërat
14 shtesë të cilat ne nuk i kemi parashikuar, siç thashë, mund të
15 kërkojnë njëfarë shtese.

16 Lidhur me këtë çështje konkrete, me intervistën e
17 dëshmitarit që kemi kryer javën që shkoi, duhet të konfirmoj
18 se nuk kemi ndonjë hetim -- detyrim të mbetur për hetim. Ka
19 disa aktivitete, veprimtari hetimore që kanë mbetur, të cilat
20 kanë një rëndësi anësore për këtë çështje dhe nuk kanë ndonjë
21 ndikim të keq lidhur me gatishmërinë tonë për të filluar
22 gjyqi.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë.

24 Z. Von Bone, dhe tani ju lutem, na bëni -- na jepni një
25 përditësim lidhur me hetimin tuaj. I keni përmbyllur hetimet?

1 Nëse jo, kur mendoni t'i përfundoni? Gjithashtu informoheni
2 Gjykatën nëse keni qëllim të jepni njoftim në lidhje me ndonjë
3 alibi, apo me shkaqe që përjashtojnë përgjegjësinë në bazë të
4 rregullës 95(5). Dhe së fundi i kërkoj Mbrojtjes nëse synon të
5 nxjerrë prova për Mbrojtjen -- për Prokurorinë, dhe nëse po,
6 sa do të jenë ato dhe kur do t'ia bëni të njohura; dhe nëse
7 kërkon masa mbrojtëse përpara nxjerrjes së provave, çfarë
8 masash dhe për sa dëshmitarë i kërkon këto masa.

9 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit shumë.

10 Mund të them sa vijon lidhur me hetimet tona: Pikësëpari,
11 çështja e alibisë. Do të ketë një alibi të paraqitur nga
12 Mbrojta. Do të ketë edhe dëshmitarë lidhur me këtë. Pres që ta
13 përfundoj -- t'i përfundojmë intervistat me këta dëshmitarë
14 brenda dy -- afërsisht brenda dy muajsh. Dhe kjo ka të bëjë
15 vetëm me alibinë sepse kjo ka përparësi, dhe do t'ju jap
16 njoftim në momentin e duhur për këtë.

17 Nuk jam i sigurt nëse do të jetë e nevojshme të kërkojmë
18 masa mbrojtëse apo jo. Nuk mund ta them, nuk e parashikoj dot
19 sesi do të ecin punët lidhur me këta dëshmitarë. Por kur të
20 ndodhë kjo gjë, sigurisht do t'ju drejtohem për t'i kërkuar
21 këto masa nëse do të nevojiten për këta dëshmitarë.

22 Një çështje të cilën ndoshta s'e kemi diskutuar ende, i
23 nderuar Gjykatës, është çështja e pikave të ligjit dhe pikave
24 të faktit -- të çështjeve të faktit.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Do të kalojmë te kjo pikë

1 më pas, kështu që t'i përmbahemi çështjes së hetimeve për
2 momentin.

3 Z. VON BONE: [Përkthim] Lidhur me hetimet, do të ketë
4 pra, siç thashë, një alibi, kjo është e sigurt. Do të ketë
5 edhe dëshmitarë të tjerë për çështje fakti të cilat përfshihen
6 në aktakuzë.

7 Nuk e parashikoj dot sesa kohë do të na duhet, por vetëm
8 për dëshmitarë që lidhen me alibinë më duhen rreth dy muaj.
9 Mendoj se brenda kësaj kohe do të mund t'i përfundojmë.

10 Ka edhe disa lloje të tjerë dëshmitarësh, të cilët
11 parashikojmë që t'i intervistojmë. Mendoj se -- më herët
12 thashë që do të duhen gjashtë deri në nëntë muaj, por tani
13 them se mbase përpara gushtit do t'i kemi përfunduar.

14 Kjo është koha, sepse nuk bëhet fjala vetëm për
15 intervistimin e dëshmitarëve por edhe për paraqitjen e disa
16 provave, pra, raporte, konstatime, vëzhgime që kemi në lidhje
17 me vendndodhje të ndryshe, të cilat duam që t'i paraqesim. Nuk
18 është përparësi në këtë çast që po flasim, thjesht sepse duhet
19 të ecim përpara me gjëra të cilat duhet t'i bëjmë më shpejt.
20 Pra, këtu jemi lidhur me hetimet me sa di.

21 Nëse do të bëj ndonjë kërkesë për mundësi unike hetimore,
22 deri tani jo. Deri sot që po flas. Nuk jam i sigurt nëse mund
23 ta parashikoj tani. Po dyshoj, pra, mendoj se jo. Kjo është
24 ideja. Kaq kishte lidhur me -- kaq kisha lidhur me hetimet.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Von Bone.

1 Znj. Prokurore -- z. Prokuror, do të thoni diçka lidhur
2 me parashtrimet e Mbrojtjes?

3 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Dua t'u përgjigjem.

4 Së pari, mendojmë që kjo çështje konkrete është
5 relativisht e qartë dhe nuk kërkon shumë hetime të mëdha në
6 lidhje me të. Ne besojmë se aktakuza, materialet mbështetëse i
7 përcaktojnë shumë qartë parametrat e çështjes. Bashkë me
8 gjithë materialet e bëra të njohura Mbrojtjes, të cilat ne ia
9 kemi nxjerrë deri tani, të gjitha këto për mbrojtjen e kësaj
10 çështjeje paraqiten në mënyrë shumë të qartë. Objekti i
11 çështjes është shumë i qartë dhe nuk ka nevojë për hetime
12 shumë të zgjeruara, apo hapa të cilat mund të kërkonin muaj të
13 ndërmerreshin, siç tha Mbrojtja.

14 Ne besojmë se me ato që ka Mbrojtja ndërkohë, me shumë
15 lehtësi mund të përgatisë mbrojtjen dhe çështjen e vetë.
16 Afatet kohore që sapo i bëri të njohura Mbrojtja - muaj tha,
17 përmendi muajin gusht si koha kur mendon t'i përfundojë
18 hetimet, është e papranueshme për ne si Prokurori. Ne në të
19 njëjtën kohë besojmë se një periudhë kaq e gjatë kohe ka një
20 ndikim negativ në të drejtat e të paditurit për një gjykim të
21 shpejtë.

22 Me këto fjalë mund të them se, sigurisht që e kuptojmë
23 dhe rëndësinë e hetimeve të kufizuara, e kuptojmë dhe
24 rëndësinë që ka paraqitja e dëshmitarëve nga Mbrojtja për të
25 provuar alibinë, apo për të konfirmuar disa mbrojtje të cilat

1 do të parashtrohen nga Mbrojtja. Megjithatë, siç thashë që në
2 fillim të kësaj seance, Prokuroria do të jetë gati brenda disa
3 javësh dhe nuk besojmë se një kohë kaq e gjatë siç kërkon, siç
4 pretendon Mbrojtja se është e nevojshme, është e
5 justifikueshme.

6 Në të njëjtën kohë dua të theksoj se Mbrojtja ndërkohë ka
7 pasur kohë të mjaftueshme për t'i kryer këto hetime.
8 Diskutimin e parë për fillimin e hetimeve nga Mbrojtja e kemi
9 zhvilluar para disa muajsh.

10 Me këto fjalë dua të theksoj edhe njëherë qëndrimin tonë
11 si Prokurori se të gjithë duhet të punojmë për fillimin e
12 gjykimit sa më shpejt, që në fillim të marsit të këtij viti,
13 mendojmë.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

15 Z. Von Bone, keni nevojë t'i zhvilloni të gjithë këto
16 hetime dhe t'i përfundoni përpara fillimit të gjykimit?

17 Z. VON BONE: [Përkthim] Do të thosha që dy të tretat e
18 hetimeve duhet të përfundojnë përpara -- hetimit. Në qoftë se
19 më lejoni, dua të trajtoj disa çështje.

20 Pikësëpari, nuk ka të drejtë Prokuroria të parashtrojë
21 argumente për punën tonë. Ata kanë pasur kohë të bollshme,
22 kanë pas vite për të bërë hetimet e tyre, ndërsa ne thjesht
23 nuk jemi në gjendja ta paraqesim -- në këto rrethana ta
24 paraqesim çështjes kaq -- brenda një kohe kaq të shkurtër.
25 Pra, lëreni Mbrojtjen të bëjë punën e saj si Mbrojtje dhe

1 Prokuroria të bëjë punën e saj. Kështu jemi më mirë, secili të
2 bëjë punën e vetë.

3 Unë pres në fakt të kem një listë më të gjatë
4 dëshmitarësh krahasuar me ata të Prokurorisë, prandaj na duhet
5 kaq kohë. Përparësia këtu është lidhur me alibinë, dhe brenda
6 dy muajsh besoj që do ta përfundojmë punën për këtë. Dhe
7 pastaj, s'mund të them një kohë të papërcaktuar, por përsëri
8 mund të them se po punojmë për këtë gjë. Do të na duhet kohë
9 pra, për të intervistuar dëshmitarët.

10 T'i përgjigjem pyetjes suaj tani. A do të kërkonte kjo që
11 të përfundoj, pra, hetimet përpara fillimit të gjyqit? Unë do
12 të preferoja, do të parapëlqejja kështu. Sepse do të shohim që
13 disa nga dëshmitarët do të kundërshtojnë ato që do të thonë
14 dëshmitarët e Prokurorisë. Dhe çështja e -- çështjet e ligjit
15 dhe të faktit lidhur me këtë pra, po mendoj dhe them se do të
16 kemi shumë vështirësi dhe mosmarrëveshje lidhur me këtë. Dhe
17 do t'i drejtohem, do t'i kthehem kësaj çështjeje pas pak.

18 Po që të paraqesim çështjen si Mbrojtje, padyshim që nuk
19 do të pajtohemi me fakte të caktuara që do të paraqesë
20 Prokuroria. Dhe për t'i argumentuar këto fakte ne do të
21 mbështetemi në dëshmitarë, dhe kjo kërkon kohë. Është shumë e
22 thjeshtë. Prandaj nuk dua që të përdor dy shpejtësi të
23 ndryshme lidhur me gjykimin. Është mirë që pasi t'i kemi
24 përfunduar hetimet tona, në një moment të themi që, "Jemi gati
25 për gjyq -- për të filluar gjyqin," dhe kjo do të ishte -- ky

1 do të ishte momenti më i mirë.

2 Supozimi im është që gushti do të ishte muaji kur ne do
3 t'i kishim përfunduar hetimet, sepse ne varemi edhe nga disa
4 faktorë palësh të treta që presim. Kaq mund të them.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Von Bone.

6 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Dua të them diçka lidhur me
7 këtë.

8 Pikësëpari, unë nuk desha që ta ofendoj Mbrojtjen. Nëse
9 tingëlloi kështu, kërkoj ndjesë. Synimi im nuk ishte ky.
10 Synimi im ishte që të nënvizoja që afatet kohore të paraqitura
11 nga Mbrojtja për sa i takon përgatitjes së procesit gjyqësor
12 nuk duken të pranueshme për ne si Prokurori. Ne sigurisht i
13 kemi kryer të gjithë hapat tonë hetimorë, hapat e tjerë sa i
14 takon respektimit të detyrimeve tona për nxjerrjen e provave
15 në dispozicion të Mbrojtjes. Këtë e kemi bërë në interes të
16 drejtësisë. Ky është qëllimi.

17 Faleminderit z. Gjykatës.

18 Z. VON BONE: [Përkthim] Nëse mund të shtoj edhe unë
19 diçka, i nderuar Gjykatës. Nëse Prokuroria e ka merak
20 kohëzgjatjen e mbajtjes në paraburgim të klientit tim,
21 sigurisht ata mund të bëjnë parashtrimet e tyre për ta liruar
22 klientin tim. Kjo është e thjeshtë. Por qëndrimi i tyre
23 gjithmonë është që, "Të ecim, të ecim." Jo. Duhet të kushtojmë
24 kohën e duhur për të vënë çdo gjë në drejtpeshim, për të
25 paraqitur argumente mbrojtëse solide edhe korrekte.

1 Nëse ka shqetësime nga ana e Prokurorisë sa i takon
2 mbajtjes në paraburgim të klientit tim, mund të bëjnë
3 parashtrime të tjera të ndryshme nga ato që kanë bërë deri
4 tani lidhur me këtë çështje. Por parashtrimet e tyre kanë qenë
5 të qarta, në rregull, por është Mbrojtja ajo që duhet të thotë
6 fjalën e vetë sa i takon kohëzgjatjes së nevojshme për
7 përgatitjen.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Von Bone.

9 Atëherë, kalojmë tani te pika tjetër në rendin e ditës,
10 që janë pikat juridike dhe faktike për të cilat palën
11 pajtohen.

12 Dua t'u drejtohem palëve që pas Konferencës së fundit për
13 Ecurinë e Çështjes, kanë pasur ndonjë progres lidhur me
14 arritjen e një marrëveshje sa i takon pikave juridike dhe
15 faktike për të cilat palët pajtohen, sipas rregullës 95(3) dhe
16 rregullës 156 të Rregullores; dhe nëse parashikojnë dhe kur e
17 parashikojnë palët se do të jenë në gjendje që të
18 identifikojnë një listë të pikave të kontestuarra dhe një listë
19 të pikave të pakontestuarra.

20 Z. Prokuror, fjalën e keni ju në fillim.

21 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit z. Gjykatës.

22 Unë do t'i trajtoj së bashku të dyja këto pika të rendit
23 të ditës. Siç e bëmë të ditur në konferencën e fundit,
24 Prokuroria ka përgatitur që dokument të plotë ku janë të
25 gjitha pikat të cilat ne mendojmë se do të jenë objekt pajtimi

1 dhe mospajtimi. Por e kemi përgatitur këtë dokument në atë
2 mënyrë që do t'u japë mundësi të dyja palëve por edhe, të
3 nderuarit z. Gjykatës, që të kuptojë se cilat janë të gjitha
4 pikat që ne besojmë janë të lidhura me këtë çështje.

5 Mendojmë se kemi qenë shumë preciz, më datë 25 janar [siç
6 u përkthye] kur ia kemi parashtruar Mbrojtjes një tabelë me
7 propozimet tona. E kam këtu këtë tabelë. Në mënyrë të
8 hollësishme i kemi paraqitur Mbrojtjes disa fakte, pikësëpari
9 që kanë të bëjë me të akuzuarin, disa fakte që kanë të bëjnë
10 me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, disa fakte që kanë të bëjnë
11 me kontekstin e kësaj çështjeje, disa fakte që kanë të bëjnë
12 me krimet e pretenduara, si edhe fakte që kanë të bëjnë me
13 çështje të tjera të ndryshme.

14 Pra, ia dërguam këtë tabelë Mbrojtjes më pas. Kam
15 biseduar me kolegun e nderuar më datë 25 janar. Gjithashtu i
16 kam dërguar një e-mail më datë 29 janar për ta -- ku i kam
17 kërkuar që nëse Mbrojtja mund të na bëjë një kundërpropozim
18 lidhur me materialin tonë. Po atë datë, më datë 29 janar kam
19 marrë një e-mail ku Mbrojtja propozon takime për pikat faktike
20 dhe juridike për të cilat ne nuk pajtohemi.

21 Ai ka sugjeruar disa data. E para, në mos gaboj, është
22 data 3 shkurt, nëse nuk e kam gabim. Dhe Prokuroria me
23 kënaqësi e pranon ftesën për takim për atë datë që është dita
24 e parë e mundshme, që bëhet fjalë për këtë të mërkurë të kësaj
25 jave, ku mund të diskutojmë për pikat juridike dhe faktike.

1 Megjithatë, në këtë aspekt, propozoj që fokusi -- që të
2 fokusohemi te dokumenti që kemi vënë në dispozicion për një
3 arsye të thjeshtë, sepse ne besojmë është shumë i qartë, është
4 shumë i hollësishëm dhe reflekton të gjitha pikat për të cilat
5 mund të diskutojmë.

6 Pa cenuar rezultatin e këtyre diskutimeve, sigurisht unë
7 mendoj që duhet të ulemi së bashku dhe t'i marrim pikat me
8 radhë. T'i japim kohë Mbrojtjes më pas që t'i diskutojë këto
9 edhe me të pandehurin për të parë se cili është qëndrimi i tij
10 për këto fakte.

11 Pra, sa më shpejt, mendojmë ne si Prokurori, t'i sqarojmë
12 këto çështje, aq më e mirë është për ne, duke pasur parasysh
13 të gjitha afatet të cilat ne i kemi paraqitur që në fillim të
14 kësaj seance sa i takon depozitimit të protokolluar të dosjes
15 paraprake dhe sa i takon fillimit të procesit gjyqësor.

16 Faleminderit.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

18 Z. Von Bone, fjala është për ju.

19 Z. VON BONE: [Përkthim] I nderuar z. Gjykatës, e
20 falënderoj kolegun tim të nderuar që na e ka vendosur në
21 dispozicion këtë dokument. Ky dokument quhet "Propozim për
22 Pajtim mbi Faktet në Pajtim me Rregullën 95." Në këtë
23 dokument, ose më shumti përmbajtja e këtij dokumenti është një
24 listë faktesh apo jo, siç na propozohen. Ka disa pika shumë të
25 lehta aty që s'janë problematike.

1 Por, në vijim do të parashtroj një çështje, të cilën
2 sigurisht do ta diskutojmë dhe me kolegun tim të nderuar nga
3 Prokuroria. Nuk duam që të ndodhemi në atë situatë ku të na
4 duhet të debatojmë për një lloj të caktuar fakti të cilin në
5 të vërtetë ne mund të mos ta kontestojmë fare. Sepse nëse
6 flasim për pikat faktike, mund të themi që, "Po, ky është
7 fakt. Na thoni cili është qëndrimi për këtë, dhe nëse
8 pajtoheni me këtë fakt apo jo." Për mua kjo është në rregull.

9 Por, i nderuar z. Gjykatës, unë nuk mendoj se është kaq e
10 lehtë sa të mund të pajtoheni për faktet dhe anën juridike.
11 Kjo nuk është ende pjesë e kësaj. Në përgjithësi p.sh., kur ka
12 -- kur flitet për konflikt të brendshëm, kur ka persona që
13 mund të konsiderohen si anëtarë apo jo të UÇK-së, e kështu me
14 radhë. Pra, këto janë ato gjëra për të cilat ne na duhen
15 sqarime, se ç'doni të thoni me këtë fakt, në mënyrë që edhe ne
16 të dimë, sepse kjo do t'i shërbente efikasitetit të gjyqimit.

17 Pse? Sepse mund të rastisë që ne të jemi dakord, të
18 pajtoheni pra, me faktin, por gjithsesi ne mund të kemi --
19 mund të mbajmë një qëndrim tonin p.sh., duam të dëgjojmë për
20 këtë apo për atë pikë faktike. Megjithatë nuk dua që të hyjmë
21 në një debat p.sh., që të themi që, "Oh, palët kanë rënë
22 dakord për të gjitha këto, kështu që i marrim të mirëqena si
23 fakt." Nuk duhet të ndodhë kështu. Unë mendoj që ky dokument
24 kërkon më shumë kohë që ne si dy palë të diskutojmë për këtë.
25 Dhe për këtë e kam fjalën, nëse kur ju parashtroji fakte dhe

1 thoni që këto fakte pasqyrojnë qëndrimin e Prokurorinë, në
2 rregull, por ne mund të themi që ne e kontestojmë, por
3 Mbrojtja nuk do të thotë që, "Ah, po mirë, po ky është
4 qëndrimi ynë për këtë çështje."

5 Nuk jam i sigurt nëse po flas qartë apo jo, por unë them
6 që të diskutojmë. Kam propozuar disa data. Është e rëndësishme
7 që në këto diskutime, së pari, të sqarojmë se ç'kuptim kanë
8 secila nga ato gjëra dhe pastaj të themi që, "Okei, ne e
9 besojmë se është kështu." Dhe nëse Mbrojtja pajtohet apo jo me
10 këtë do të -- nëse pra, Mbrojtja pajtohet apo jo me atë që
11 thuhet në dokument, pajtohet apo nuk pajtohet, në rregull. Po
12 nuk dua që të ndodhemi në atë situatë ku Mbrojtja dhe
13 Prokuroria të mbështeten në diçka, kur të themi: "Oh po dale,
14 këtë nuk e kemi -- këtë të mos ta diskutojmë se për këtë kemi
15 rënë dakord, për këtë jemi pajtuar."

16 Është mirë për këtë proces gjyqësor që të shikojmë nëse
17 faktet janë vërtet faktet siç na propozohen. Prandaj dhe unë
18 mendoj që na duhet që të ulemi së bashku dhe të sqarohemi për
19 këtë.

20 Ka një sërë çështjesh të cilat s'kanë nevojë për sqarim.
21 Datëlindja e klientit tim nuk ka nevojë për verifikim as
22 sqarim. Por ka pika të tjera faktike, nëse UÇK-ja është një
23 organizatë e tillë apo e atillë, nëse UÇK-ja p.sh., i merrte
24 urdhrat nga ky apo nga ai, nëse këta, zoti X apo zoti Y kanë
25 qenë apo jo pjesë e Shtabit të Përgjithshëm. Ja, këto janë

1 disa pika faktike që edhe mund të diskutojmë. Nëse një brigadë
2 e caktuar ushtronte aktivitet në fakt, pra, në të vërtetë në
3 një zonë të caktuar, kjo është një pikë faktike për të cilën
4 na duhen sqarime për të evituar një situatë ku të themi që,
5 "Ah, për këtë jemi pajtuar, kjo është kopsitur," dhe nuk e
6 diskutojmë dot më tutje.

7 Unë këtë kam pasur në mendje kur i jam drejtuar me e-mail
8 kolegut tim të nderuar nga Prokuroria, ku i kam propozuar që
9 të ulemi së bashku e të diskutojmë. Unë mendoj se do të
10 punojmë së bashku, dhe nëse punojmë së bashku mirë, i vihemi
11 kësaj pune, brenda muajt mund -- brenda një muaji pra, mund ta
12 përfundojmë. Personalisht unë parashikoj se do të përpigem që
13 këtë dokument ta kryej brenda fundit të muajit, me kusht, e
14 përsëris, me kusht që të më jepet mundësia që ta diskutoj këtë
15 dokument me klientin tim.

16 Dokumenti është në anglisht. Do kohën e vetë që ta
17 shfletosh. Po ta kisha një dokument në shqip, po ta kisha të
18 përkthyer në shqip do ta kisha më të lehtë për ta diskutuar me
19 të, do të ishte më efikase sigurisht. Unë idenë time e kam për
20 ta mbyllur brenda muajit, por e përsëris, këtë e them vetëm po
21 të jepet mundësia ta diskutoj plotësisht me klientin tim. Kjo
22 është çështje e rëndësishme.

23 Ky është parashtrimi im, i nderuar z. Gjykatës.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Von Bone.

25 Edhe unë këtë ide kisha, që ta -- që të mbyllej brenda

1 një muaj pra, duke filluar nga -- ama duke filluar nga
2 konferenca e fundit. Kisha shpresuar që të kishte përfunduar
3 tashmë. Por më bëhet qejfi që të paktën keni filluar
4 diskutimet për këtë.

5 Z. Prokuror, dëshironi t'u përgjigjeni këtyre? Edhe sa i
6 takon afatit të propozuar për diskutimet që do të jetë fundi i
7 këtij muaji pra, fundi i shkurtit.

8 Z. WHITING: [Përkthim] Nëse mund t'i trajtoj unë këto
9 çështje.

10 Mua më duket se ky proces po tingëllon shumë më i
11 komplikuar nga ç'është në të vërtetë. Ne propozojmë fakte.
12 Nëse pajtohemi për këto fakte, ato do të hiqen nga tabela për
13 t'u përfshirë në gjykim. Nëse avokati nuk do që të pajtohet
14 për këto fakte, mirë, s'ka problem. Nuk kemi nevojë për një
15 marrëveshje për këtë dhe do t'i -- për këto do t'i bëjmë
16 objekt ndërgjyqësie. Unë nuk shikoj arsye për ta vonuar më tej
17 këtë proces.

18 Ne kemi propozuar disa fakte. Me kënaqësi do të
19 diskutojmë gjithçka. Z. Von Bone mund të organizojë përkthimin
20 e tyre. Nëse është e nevojshme mund të vëmë në dispozicion
21 edhe ne një përkthyes në takimet me klientin, por nuk duhet që
22 të kërkojë më shumë se një muaj kohë. Është një procedurë
23 shumë e thjeshtë.

24 Meqenëse jam ngritur për të folur, kam marrë fjalën, do
25 të doja që t'i kthehesha çështjes së hetimeve dhe datës së

1 procesit gjyqësor për ta bërë të qartë qëndrimin e zyrës sonë.

2 Kërkesa për të vijuar hetimet deri në gusht, sipas
3 mendimit tonë, është e jashtëzakonshme kur aktakuza është bërë
4 e ditur që para katër muajsh. Pra, deri tani Mbrojtja ka pasur
5 katër muaj për t'i kryer këto hetime, dhe unë mendoja se këto
6 hetime ishin zhvilluar.

7 Tashti që Mbrojtja të kërkojë dhe gjashtë muaj të tjerë,
8 si edhe kur na thonë që duhen edhe dy muaj për të na paraqitur
9 një alibi, është jashtë proporcioneve. Duke pasur parasysh
10 llojin e çështjeve, është një çështje shumë e ngushtë, me një
11 objekt shumë të ngushtë, me një fushëveprim dhe gjeografi të
12 ngushtë. Është një çështje që mbulon një ngjarje që ka ndodhur
13 brenda dy deri tri javë. Pra, rrethanat e kësaj ngjarjeje edhe
14 e kësaj çështjeje janë shumë specifike.

15 Unë nuk mendoj se i takon Mbrojtjes që të vendosë afatet
16 për fillimin e çështjes, i takon z. Gjykatës. Z. Gjykatës do
17 të ishte mirë t'i merrte këto vendime dhe duhet t'i marrë këto
18 vendime në bazë të interesave të të akuzuarit që po mbahet në
19 paraburgim, por edhe në bazë të interesave të publikut edhe të
20 viktimave të cilat presin që kjo çështje të zgjidhet sa më
21 shpejt.

22 Prandaj ne e kuptojmë që Mbrojtja ka nevojë për kohë për
23 të bërë hetimet e veta. Mirë është që ta kenë kohën që të
24 hetojnë sepse duam që kjo çështje të debatohet siç duhet, të
25 mbrohet siç duhet. Kjo është edhe në interesin tonë, por që ta

1 zvarrisim deri në gusht, duke pasur parasysh edhe faktet edhe
2 kërkesat e kësaj çështje, është e papërligjur, vërtetë e
3 papërligjur.

4 Unë mendoj që është një afat i cili nuk është realist. Sa
5 më shpejt që z. Gjykatës të vendosë afate për fillimin e
6 çështjes pra, për fillimin e procesit gjyqësor, aq më mirë
7 është për ne, se të paktën ta dimë, të kemi një orientim. Gjë
8 që unë ju kërkoj, që kjo të trajtohet dhe t'i jepet një afat i
9 arsyeshëm, e përsëris, i arsyeshëm Mbrojtjes që të kryejë
10 hetimet e veta.

11 Faleminderit.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

13 Z. Von Bone.

14 Z. VON BONE: [Përkthim] Tani, pikat faktike janë më të
15 ndërlikuara sepse kanë pasoja për dëshmitarët të cilët ne do
16 t'i intervistojmë. Nëse ne thjesht themi që do të debatojmë,
17 do të kontestojmë pra, diçka, kjo në fakt nuk i ndihmon
18 argumentet mbrojtëse.

19 Në fakt, qëndrimi i Prokurorisë sa i takon fakteve se ka
20 njëlloj baze apo njëlloj qendre paraburgimi, apo një kamp
21 paraburgimi në një zonë të caktuar që administrohet nga një
22 njësi e caktuar, kjo është një çështje që nuk është thjesht
23 objekt debati, por është edhe një çështje që ngre pikëpyetjet
24 e veta për ne si Mbrojtje. A mund t'i identifikojmë dot
25 dëshmitarët e duhur apo jo?

1 Ne mbase mund të themi që ekzistonte p.sh., një shkollë
2 në Zllash, apo ekzistonte një shtëpi në Zllash, por se çfarë
3 ishte kjo shtëpi apo jo, çfarë statusi kishte, çfarë përdorimi
4 kishte, kjo ka rrjedhoja për argumentet mbrojtëse sa i takon
5 qëndrimin që do të mbajmë ne.

6 Unë nuk dua që të debatoj këtu në sallën e gjyqit për
7 diçka për të cilën nuk do të mbështetem nëpërmjet
8 dëshmitarëve. Prandaj edhe ne, unë e thashë, po përpiqemi
9 shumë që të gjejmë dëshmitarë lidhur me shumë pika faktike, të
10 cilët të dëshmojnë këtu pro të pandehurit dhe të shikojnë edhe
11 për faktet, nëse këto janë fakte -- janë fakte apo nëse këto
12 fakte gjithashtu a janë ashtu siç paraqiten apo jo në
13 Aktakuzën e Konfirmuar.

14 Pra, kjo sigurisht -- i takon Trupit Gjykses në një
15 moment të caktuar që të marrë një vendim për këtë sigurisht,
16 por për Mbrojtjen është e rëndësishme që ne si Mbrojtje të
17 kemi kohën e duhur në dispozicion që të arrijmë në këtë pikë.
18 Ne duam edhe ta përshpejtojmë procesin gjyqësor sigurisht.

19 Pra, për këtë arsye unë mendoj se është më e komplikuar,
20 për këtë gjë.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Von Bone.

22 Në lidhje me këtë pikë, ju nuk keni detyrimin që të
23 pajtoheni me faktet. Kjo është pika e parë.

24 Pika e dytë është që, ky nuk është momenti për të
25 debatuar faktet. Kjo do të bëhet në gjykim. Pra, në qoftë se

1 nuk jeni i sigurt për disa fakte, në qoftë se nuk keni pasur
2 mundësi të keni sqarim të mjaftueshëm, ju thjesht thoni që nuk
3 pajtoheni me faktin. Kaq.

4 Pra, marrëveshja është për të përshpejtuar procedurën dhe
5 nuk jeni të detyruar që të diskutoni për çështjet për të cilat
6 do të diskutohet në gjyq. Po unë e kuptoj se çfarë çështje
7 ngrini. Ju nuk keni -- nuk jeni sqaruar për një pikë të
8 caktuar dhe kur thoni këtë që, ju nuk keni rënë dakord për
9 diskutimin e një çështjeje, kjo nuk do të thotë që ju duhet
10 t'i diskutoni këto çështje në këtë fazë. Por marrëveshja në
11 këtë fazë është që ju nuk keni detyrimin që të keni të gjitha
12 faktet e çështjes në fazën paraprake. Pra, në këtë fazë
13 paraprake nuk ka nevojë të hyhet në hollësitë e çështjes.

14 Z. VON BONE: [Përkthim] Çështja është -- pyetja është: Në
15 qoftë se thuhet që, "A pajtoheni me faktin?" Atëherë kjo
16 nënkupton që ai është fakt. Unë them që a është fakt apo jo,
17 kjo mbetet për t'u përcaktuar. Dhe ky është një fakt që duhet
18 ta provojë Prokuroria në mënyrë që ta deklarojë atë dhe ta
19 bëjë fakt.

20 Pra, përndryshe në qoftë se themi: "Mbrojtja nuk pajtohet
21 me këtë fakt. Atëherë, le të kenë ata pozicionin e tyre dhe
22 Mbrojtja pozicionin e vetë." Por nuk është ashtu, është -- i
23 takon Prokurorisë që të përcaktojnë në lidhje me një fakt të
24 caktuar nëse është fakt dhe të japin arsye për këtë.

25 Thjesht të thuash që, "A je dakord me këtë fakt?"

1 nënkupton që ai është fakt, dhe jo se mbetet për t'u parë a
2 është fakt apo jo. Prandaj mendoj që është e dobishme që unë
3 dhe kolegët e mi të palës tjetër të kemi këtë sqarim, sepse
4 kur të jemi në gjendje të pajtohemi për këto çështje, atëherë
5 do të bëhet shumë më e lehtë. Pra, në qoftë se ne themi që,
6 "Ai fakt i caktuar është fakt, nuk është i diskutueshëm," nuk
7 ka nevojë të diskutohet më tej.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Von Bone.

9 A pajtohen palët që të përfshihen në diskutime për këtë
10 shumë shpejt, dhe a mund të kemi një propozim pra, për këtë
11 javë, dhe a mund të pajtohen palët që këto diskutime të
12 përfundojnë në fund të shkurtit?

13 Z. Prokuror.

14 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Ne do të dëshironim ta bënim
15 mundësisht më herët. Dita e parë që përmendi Mbrojtja ishte të
16 mërkurën. Ne jemi dakord që të ulemi me ta për të sqaruar çdo
17 pikë që nuk është e qartë në këto dokumente. Dhe në qoftë se
18 Mbrojtja nuk është dakord me një fakt të caktuar, atëherë ne
19 mund t'i diskutojmë, t'i debatojmë faktet. Dhe në fillim duhet
20 të biem dakord se cilat janë faktet për të cilat pajtohemi në
21 mënyrë që të hapim rrugën për fillim e gjykimit.

22 Z. VON BONE: [Përkthim] Unë propozoj që të bëhen katër
23 seanca diskutimi me Prokurorinë, fillimisht dy. Por e kam
24 fjalën, sa për ta sqaruar, që bëhet fjalë për çështje të
25 faktit dhe jo çështje të ligjit. Dhe në qoftë se do të kemi

1 diskutime të ngjashme për çështje të ligjit, atë mund ta
2 diskutojmë më vonë.

3 Por në lidhje me këtë dokument duhet -- besoj që të
4 arrijmë marrëveshje brenda një muaji. Shpresoj që Prokuroria
5 mund të më japë versionin në shqip, sepse është shumë më e
6 lehtë për klientin tim që të punojë me versionin shqip, dhe në
7 diskutimet që do të kem me të puna ime bëhet shumë më e lehtë.
8 Unë do të bëj ç'është e mundur që të diskutoj të gjitha temat
9 me të. Dhe kur të kemi sqarim në lidhje me këto çështje, unë
10 mund t'i fus këto sqarime edhe në diskutimin që do të bëj me
11 klientin tim. Dhe mund të themi pastaj si përfundim që, "Okei,
12 kjo ka mbaruar dhe është hequr nga lista."

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Von Bone.

14 Pra, nga diskutimet tuaja kuptoj që mbas një muaji do të
15 ketë përfunduar diskutimi për këto çështje. Dhe nëse do të
16 ketë marrëveshje apo nuk do të ketë marrëveshje, kjo do të
17 jetë -- ky do të jetë afati për të arritur marrëveshje në
18 lidhje me këtë temë.

19 Z. VON BONE: [Përkthim] Në rregull.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Asgjë s'ju pengon që të
21 bini në marrëveshje edhe më herët se kaq, por kjo nuk do të
22 jetë më vonë se fundi i këtij muaji.

23 Z. VON BONE: [Përkthim] Kur të kemi mbaruar këto
24 diskutime, do t'jua japim rezultatet e diskutimit ju? Kjo
25 është ideja apo jo? Në fund të muajit apo në fillim të marsit.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

2 Për pikën tjetër të rendit të ditës i drejtohem
3 Mbrojtjes.

4 A keni ndërmend të dorëzoni dosjen paraprahe sipas
5 rregullës 95(5) të Rregullores? Dhe në qoftë se po, kur do të
6 jeni në gjendje ta dorëzoni këtë dosje? Po kështu dua të
7 dëgjoj nga palët në lidhje me një datë të propozuar për
8 përcjelljen e çështjes te Trupi Gjykues i çështjes, në bazë të
9 rregullës 98(1) të Rregullores.

10 Kjo është në vijim të diskutimeve që sapo i kemi filluar
11 tashmë, por dua që Mbrojtja të thotë këtu në Gjykatë se kur
12 është në gjendje -- kur të jetë gati për të hyrë në fazën e
13 gjykimit.

14 Z. Von Bone.

15 Z. VON BONE: [Përkthim] Pika e parë, se kur do të
16 dorëzohet dosja paraprahe dhe nëse kemi ndërmend të dorëzojmë
17 një të tillë. Besoj kjo do të jetë pas përfundimit të hetimeve
18 të Mbrojtjes. Atëherë do të jetë koha se kur do ta dorëzojmë.
19 Pra, përpara se të fillojë çështjen e vetë, argumentet e veta
20 Mbrojtja, atëherë do të dorëzojmë dosjen tonë paraprahe.

21 Për sa i përket momentit se kur duhet të fillojë gjykimi,
22 i nderuar Gjykatës, nuk kam një datë të përcaktuar në mendje,
23 nuk e kam të qartë se kur mund të jetë kjo datë. Është e qartë
24 që Mbrojtja ka nevojë për më shumë kohë për të përfunduar
25 hetimet e veta dhe mendoj që do të ishte e dobishme që gjykimi

1 të fillojë pasi Mbrojtja të ketë përfunduar hetimet e veta.
2 Dhe sipas mendimit tim, dhe duke pas parasysh numrin e
3 dëshmitarëve që parashikojmë të thërrasim, dikur nga korriku,
4 në atë periudhë kohore. Ndoshta nuk do t'i kemi përfunduar
5 plotësisht hetimet tona, por kjo është një kohë e përafërt që
6 mund të jap.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Von Bone.
8 Z. Prokuror.

9 Z. WHITING: [Përkthim] Duke qenë se fillova unë të
10 diskutoj për këtë çështje, do të vazhdoj.

11 Unë nuk do të përsëris ato që thashë se ne e kemi bërë të
12 qartë pozicionin tonë. Ka pasur kohë të mjaftueshme për hetime
13 në këtë rast, kështu që duhet t'i kalohet çështja Trupit
14 Gjykues në mars. Në qoftë se ju doni t'i jepni Mbrojtjes më
15 shumë kohë, mendoj që -- dhe të shtyhet koha e fillimit të
16 çështjes, atëherë mendoj që kjo të jepet me një vendim.

17 Z. VON BONE: [Përkthim] E ritheksoj, i nderuar Gjykatës,
18 që ne jemi në një presion shumë të madh që të dorëzojmë
19 dokumente për protokollim shumë shpejt, apo të ecin çështjet
20 përpara, por balanca nuk është balanca e duhur.

21 Pra, dua ta theksoj që është shumë e rëndësishme që
22 Mbrojtja të ketë kohën që i nevojitet në mënyrë që t'i
23 përfundojë hetimet e veta.

24 Z. WHITING: [Përkthim] Mendoj që ky është një argument
25 fals. Ne nuk kemi pasur vite. Ne kemi punuar për vite, por

1 kemi pasur shumë çështje për të hetuar dhe jo vetëm këtë. Dhe
2 detyrimi ynë është shumë më i ndryshëm nga i Mbrojtjes. Ne
3 duhet të vërtetojmë një çështje përtej dyshimit të arsyeshëm
4 dhe të bëjmë akuza mbi bazën e kësaj.

5 Mbrojtja, nga ana tjetër, e ka çështjen ndryshe. Pra, ata
6 kanë një aktakuzë të përcaktuar dhe i jepen materiale të cilat
7 -- bëhet nxjerrja e tyre dhe duhet t'i përgjigjet asaj
8 çështjeje. Mbrojtja duhet të ketë kohë të mjaftueshme për të
9 hetuar, por kjo nuk është e krahasueshme me atë që ka për të
10 bërë Mbrojtja, dhe nuk mund të maten në mënyrë të njëjtë dhe
11 të krahasohen.

12 Duke pas parasysh natyrën e kësaj çështjeje, gamën e
13 ngushtë të çështjeve që diskutohen, ne duhet të fillojmë
14 çështjen -- gjykimin e çështjes sa më shpejt që të jetë e
15 mundur.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Von Bone, përpara sesa
17 të flisni, unë ju kam pyetur në çdo urdhër që kam dhënë për
18 datat e Konferencave për Ecurinë e Çështjes, ju kam pyetur aty
19 se a keni çështje të alibisë për të ngritur apo jo.

20 Pra, e kuptoj menjëherë -- e kuptoj shumë mirë që keni
21 nevojë për hetimet tuaja, por edhe këto duhet të jenë të
22 arsyeshme.

23 Z. VON BONE: [Përkthim] Po mendoj që gama e çështjes
24 është shumë më e madhe sesa paraqitet këtu, sepse ka shumë
25 gjëra që duhet të diskutohen dhe të argumentohen në lidhje me

1 Aktakuzën e Konfirmuar. Në qoftë se kjo, thuhet nga pala
2 tjetër, që është çështje e qartë dhe e ngushtë, unë nuk jam --
3 nuk pajtohem me këtë sepse ka plot çështje të faktit të cilat
4 -- për të cilat nuk jemi dakord. Të kundërshtosh diçka vetëm
5 me fjalë, nuk ka kuptim. Për ta kundërshtuar diçka duhet të
6 jesh në gjendje të mbështetesh në dëshmitarë që mund të thonë
7 diçka në lidhje me atë fakt. Dhe t'i gjesh këto fakte është
8 një detyrë goxha e madhe.

9 Prokuroria ka pasur dhe ka gjithmonë më shumë mjete për
10 t'i kryer hetimet e veta, dhe mjete kryesor që kemi ne, më i
11 mirë që kemi ne është që të na jepet më shumë kohë për të
12 kryer hetimet tona. Sepse përndryshe në një moment të caktuar
13 ne mund të përballemi me një fakt edhe mund të thuhet që, "Oh,
14 kemi gjetur këtë dëshmitar, atë dëshmitar, dhe duam t'i
15 sjellim ata të japin dëshmi në lidhje me këtë ose atë pikë."
16 Kjo nuk ka kuptim, kjo do ta vononte çështjen.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Von Bone.
18 Z. Prokuror.

19 Z. WHITING: [Përkthim] Nuk kam asgjë për të shtuar.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] A kanë palët ndonjë çështje
21 tjetër që duan të ngrenë që nuk është diskutuar? Në qoftë se
22 mundem, a mund t'i kujtoj palët që të japin njoftim nëse këto
23 parashtrime që do të bëni do të kenë nevojë për nxjerrjen e
24 informacionit konfidencial në mënyrë që të futemi në seancë
25 private.

1 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Nuk kemi asgjë tjetër për të
2 shtuar.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Von Bone.

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Është çështja e një pale të tretë
5 që është përfshirë që është -- që e bën shumë të vështirë
6 punën e Mbrojtjes. Kjo na ka marrë shumë kohë, shumë më tepër
7 kohë sesa duhet. Dhe shpresoj që gjatë këtij muaji me këtë
8 palë të tretë do të kemi një diskutim në mënyrë që Mbrojtja të
9 mund të eci përpara. Kjo ka qenë një nga çështjet që ka
10 paraqitur vështirësi për Mbrojtjen.

11 Vazhdoj të flas në mënyrë pak të mjegullt këtu sepse nuk
12 dua të hyj në hollësitë e kësaj çështjeje, por ju siguroj që
13 kjo na e ka bërë punën shumë më të ndërlikuar. Dhe gjithashtu,
14 i nderuar Gjykatës, që në fillim të kësaj çështjeje Mbrojtja
15 ishte thjesht -- Mbrojtja thjesht nuk kishte mundësi të ecte
16 përpara me hetimet.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Von Bone.

18 Z. WHITING: [Përkthim] Mbrojtësi po flet pak si në mënyrë
19 të koduar për gjërat që sapo tha, po kjo ngre disa shqetësime
20 në lidhje me individët ose organizatat që kanë lidhje me punën
21 e Mbrojtjes. Kjo është diçka që duhet t'i vihet në vëmendje
22 Gjykatës në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejt sa më shpejt
23 që të jetë e mundur, sepse nuk duam të arrijmë në një situatë
24 ku aftësia e Mbrojtjes për të operuar të komprometohet.

25 Unë e lë këtë në gjykimin e Gjykatësit, por do ta nxisja

1 që kjo çështje të diskutohet dhe të ngrihet sa më shpejt që të
2 jetë e mundur, sepse në qoftë se kjo ka ndikim në çfarëdo
3 mënyre në funksionimin e duhur të Mbrojtjes, kjo duhet bërë sa
4 më shpejt.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Von Bone.

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Siç e thashë, do të kem -- do të
7 sqarohem më tej në lidhje me këtë çështje gjatë këtij muaji,
8 sepse kam një indikacion të qartë që çështja do të zgjidhet.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] A duhet të më drejtoheni
10 mua *ex parte* në lidhje me këtë çështje për të më informuar?

11 Z. VON BONE: [Përkthim] Dhe në seancë të mbyllur?

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Po.

13 Z. VON BONE: [Përkthim] Po. Do të ishte e dobishme.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Apo doni ta paraqisni me
15 shkrim?

16 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo. Mund ta ngre këtë çështje me
17 gojë.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Atëherë, të bëjmë pushim
19 për 10, 15 minuta në mënyrë që ta bëjmë këtë seancë *ex parte*
20 tani. A është e mundshme për Prokurorinë që të mblidhemi
21 përsëri shkurtimisht pas kësaj seance *ex parte*?

22 Z. WHITING: [Përkthim] Po, patjetër.

23 Z. VON BONE: [Përkthim] Atëherë, z. Von Bone, do të vijmë
24 përsëri në orën 12.30 për një seancë *ex parte* për të diskutuar
25 këtë, dhe pastaj do të ftojme përsëri të vijë dhe Prokuroria

1 për të përfunduar këtë Konferencë për Ecurinë e Çështjes.

2 --- Pushimi fillon në orën 12.18

3 --- Rifillon në orën 13.09

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Jemi rikthyer në seancë
5 publike.

6 Në përfundim të kësaj seance për Ecurinë e Çështjes dua
7 t'i pyes palët nëse kanë diçka për të shtuar krahas atyre që
8 kemi diskutuar në rend të ditës.

9 Z. Prokuror.

10 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Jo, nuk kemi asgjë për të
11 shtuar.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

13 Z. Von Bone.

14 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo, i nderuar z. Gjykatës. Nga
15 ana e Mbrojtjes nuk kam asgjë për të shtuar. Faleminderit.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Von Bone.

17 Përpara se të kalojmë te data e seancës së ardhshme, për
18 Konferencën e ardhshme për Ecurinë e Çështjes, dua të kaloj në
19 seancë private shumë shkurt për të diskutuar me palët për
20 parashtrimet e protokolluara të fundit.

21 Z. Sekretare, ju lutem na informoni kur të kalojmë në
22 seancë private.

23 [Seancë Private]

24

25

1
2
3
4
5
6
7
8
9
10
11
12
13
14
15
16
17
18
19
20
21
22
23
24
25

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi rikthyer në seancë
publike z. Gjykatës.

GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj.
Sekretare.

Z. Prokuror, keni ndonjë parashtrim sa i takon datës për
Konferencën e pestë për Ecurinë e Çështjes për këtë çështje?

Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Nuk kemi ndonjë preferencë.

1 Mund të them vetëm se, siç e kemi thënë më përpara edhe
2 në këtë seancë, ne do të ishim shumë të kënaqur që ta
3 finalizonim këtë procedurë paraprake sa më shpejt që të ishte
4 e mundur.

5 Nga ana jonë, ne s'kemi më nevojë për Konferencë për
6 Ecurinë e Çështjes sepse nga ana jonë ne jemi të qartë, por
7 nëse ju si Gjykatës e caktoni një të tillë, unë do të thosha,
8 mbase nga fundi i shkurtit, jo më herët se aq. Faleminderit.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.
10 Z. Von Bone, për datën e konferencës së ardhshme.

11 Z. VON BONE: [Përkthim] Unë do të thosha mbas dy muajsh.
12 Thjesht arsyeja është se atëherë do të kem një ide mbase më të
13 qartë se ku kemi shkuar me hetimet tona, dhe mbase dhe për të
14 pasur një ide për një datë më të hershme për fillimin e
15 procesit gjyqësor. Faleminderit.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Von Bone.

17 Atëherë, këtu e kemi mbyllur seancën sot. Falënderoj
18 palët dhe zyrën administrative për pjesëmarrjen. Falënderoj
19 përkthyesit, stenografët, teknikët audiovizivë dhe personelin
20 e sigurisë për pjesëmarrjen.

21 Këtu e mbyllem këtë seancë.

22 --- Konferenca për Ecurinë e Çështjes përfundoi në
23 orën 13.13

24

25